



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVA

ZYRA E AUDITORIT TË PËRGJITHSHËM/OFFICE OF THE AUDITOR  
GENERAL/KANCELARIJA GENERALNOG REVIZORA

**Nr. Dok: 21.0.1-2009-08**

**RAPORT I AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIARE TË KUVENDIT  
TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS PËR VITIN E PËRFUNDUAR MË  
31 DHJETOR 2009**

**Prishtinë, Korrik 2010**

## **Tabela e përmbajtjes**

- I. Përmbledhje e përgjithshme
- II. Hyrje
- III. Gjendja e rekomandimeve nga vitet e kaluara
- IV. Fushëveprimi i auditimit
- V. Qasja e auditimit
- VI. Opinioni i auditimit
- VII. Të gjeturat dhe rekomandimet kryesore të auditimit

### Shtojcat:

- I. Llojet e ndryshme të Opinioneve të Auditimit (ISSAI 400)
- II. Komentet e Kuvendit dhe Përgjigjet e ZAP-it ndaj komenteve

## **Lista e shkurtesave dhe fjalëve**

AK	Autoriteti Kontraktues
BKK	Buxheti i Konsoliduar i Kosovës
PF	Pasqyrat Financiare
INTOSAI	Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit
LPP	Ligji Nr. 2003/17 Për Prokurimin Publik në Kosovë me ndryshimet dhe plotësimet e datës 8 shkurt 2007
MEF	Ministria e Ekonomisë dhe Financave
MAP	Ministria e Administratës Publike
KPM	Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës
OE	Operatori Ekonomik
OB	Organizatë Buxhetore
SNISA	Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit
SNKSP	Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik
UA	Udhëzim Administrativ
UOP	Urdhër Obligim Pagese
ZAP	Zyra e Auditorit të Përgjithshëm

## I. Përmbledhje e përgjithshme

Zyra e Auditorit të Përgjithshëm (ZAP), ka kryer auditimin e Pasqyrave Financiare të Kuvendit të Republikës së Kosovës (më tutje Kuvendi), për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2009.

Auditimi jonë është kryer, në përputhje me standardet ndërkombëtare të auditimit të hartuara nga INTOSAI dhe ka përfshirë testet dhe procedurat që ne menduam se ishin të nevojshme, për të dhënë një opinion lidhur me pasqyrat financiare.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare *prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë* në të gjitha aspektet materiale, pozitën financiare për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2009, në pajtim me standardet ndërkombëtare të kontabilitetit për sektorin publik (SNKSP) “raportimi financiar, në bazë të kontabilitetit të parasë së gatshme”. (SNISA 400 *Opinion i Pakualifikuar*)

Përkundër raportimit të duhur financiar, auditimi ynë ka identifikuar dobësi të caktuara në fushën e menaxhimit financiar dhe kontrolleve, por të cilat nuk ndikojnë materialisht në kualitetin dhe besueshmërinë e të dhënave të paraqitura në Pasqyra Financiare.

Dobësitë kryesore të identifikuara janë si në vijim:

- Planifikim i dobët i Buxhetit për Investime kapitale dhe ridestinimi i mjeteve në projekte tjera jashtë planit;
- Shpалosje jo e plotë e Pasurive jofinanciare në Pasqyrat Financiare;
- Pagesa të kryera jo sipas kushteve të parapara me kontratë sidomos te projektet kapitale si dhe mungesë e një mbikëqyrje adekuate të projekteve;
- Zhvillimi i prokurimit kryesisht në fund të vitit është përcjellur me dobësi dhe vonesa në përmbushjen e kontratave sipas planit dinamik;
- Menaxhimi i pasurive përkundër përmirësimeve ende ka nevojë për një kompletim dhe prezantim adekuat;
- Kontrolle të pamjaftueshme me rastin e realizimit të pagesave në fund të vitit; dhe
- Auditimi i brendshëm nuk është fokusuar në fushat me rëndësi materiale siç janë Prokurimi dhe Menaxhimi i Pasurive për periudhën e vitit 2009.

Mbështetur në gjetjet tona, ne rekomandojmë menaxhmentin e Kuvendit të ndërmerr aktivitete të nevojshme me qëllim të përforcimit të kontrolleve të brendshme, duke e përmirësuar njëkohësisht menaxhimin financiar.

Menaxhmenti i Kuvendit ka dhënë komente mbi draftin e këtij raporti. Më pas një numër i ndryshimeve është bërë në këtë raport.

Çështjet e papërfunduara, për të cilat ne si auditorë dhe entiteti i audituar ende kemi pikëpamje të ndryshme, mund ti gjeni në Shtojcën 2.

Menaxhmenti është zotuar që do ti bëjnë të gjitha përpjekjet për ti adresuar të gjitha rekomandimet e dhëna.

## **II. Hyrje**

Zyra e Auditorit të Përgjithshëm (ZAP) është përgjegjëse për kryerjen e auditimeve vjetore të rregullsisë të Institucioneve Publike të Kosovës.

Është përgjegjësi e Kuvendit të Republikës së Kosovës të përgatisë pasqyrat financiare në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik (SNKSP), për “Raportimin financiar në bazë të kontabilitetit të parasë së gatshme”, në përputhje me Udhëzimin Administrativ 20/2009, dhe ato ti prezantoj me kohë.

## **III. Objektivi dhe Fushëveprimi i auditimit**

Ky auditim i Kuvendit ka të bëjë me Pasqyrat Financiare për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2009.

Auditimi i Rregullsisë është definuar si verifikim i kontabilitetit financiar, duke përfshirë ekzaminimin dhe vlerësimin e pasqyrave financiare dhe të dhënave tjera financiare si dhe dhënien e opinionëve:

- Nëse pasqyrat financiare japin një pamje të drejtë dhe të vërtetë të llogarive dhe çështjeve financiare për periudhën e auditimit;
- Nëse të dhënat financiare, sistemet dhe transaksionet janë në pajtim me ligjet dhe rregulloret në fuqi;
- Për përshtatshmërinë e funksioneve të kontrollit të brendshëm dhe të auditimit të brendshëm; dhe
- Për të gjitha çështjet të cilat dalin apo kanë të bëjnë me auditimin.

## **IV. Qasja e auditimit**

Qasja jonë e auditimit është zhvilluar gjatë këtij viti. Kemi adaptuar manualin e ri për auditimin tonë të rregullsisë që është konform standardeve të auditimit të njohura ndërkombëtarisht.

Qasja jonë e auditimit është fokusuar në katër fusha kryesore:

- Të kuptuarit e Entitetit - të kuptojmë plotësisht entitetin, përfshirë këtu edhe kornizën e autoriteteve dhe të sistemeve kyçe, në mënyrë që të kuptojmë çështjet kyçe të cilat mund të kenë ndikim në pasqyrat financiare;
- Identifikimi i Rrezikut: duke kuptuar Entitetin dhe nga rezultatet e mëhershme të auditimit, ne identifikojmë rreziqet të cilat mund të shpijnë në keq deklarim material në pasqyra financiare ose mospërputhshmëri me ligjin;
- Kontrollat e Brendshme të Menaxhimit: aty ku identifikohen rreziqet, ne kërkojmë të identifikojmë menaxhimin dhe kontrollat monitoruese të cilat mund të zvogëlojnë ato rreziqe; dhe
- Përdorimi i Procedurave Substanciale dhe Analitike - për të ofruar një siguri të auditimit me vëmendje të veçantë tek fushat ku dobësitë në kontrolle janë identifikuar.

Ne duhet kuptuar kontrollat e brendshme mjaftueshëm për të vlerësuar rrezikun e keq deklarimit material. Në përputhje me këtë kërkesë dhe punës sonë sipas kontrolleve të brendshme të menaxhimit të theksuara më lart, ne dokumentojmë kontrollat e menaxhimit dhe ato monitoruese që të na ndihmojnë në informimin e gjykimit tonë për rreziqet e keq deklarimit material.

Ne planifikojmë dhe kryejmë auditimin për të qenë në gjendje të ofrojmë siguri të arsyeshme. Ne aplikojmë materialitetin për të na ndihmuar në planifikimin e auditimit tonë dhe vlerësimin e të gjeturave tona të auditimit. Në terme të përgjithshme, ( siç specifikohet në standardet e auditimit) ne konsiderojmë që një çështje është materiale nëse mos shpalosja, keq deklarimi, përfshirja ose lënie jashtë e saj, me gjasë do të mund të ndërronte pikëpamjen e përgjithshme të dhënë nga pasqyrat financiare tek shfrytëzuesit.

Sipas qasjes sonë të rishikuar të auditimit, ne ndërmorëm një auditim të parakohshëm përgjatë këtij viti. Auditimi i parakohshëm duhet të kuptohet si një auditim që fillon nga viti fiskal që është nën auditim me qëllim të dhënies së rekomandimeve mbi atë se si mund të trajtohen rekomandimet e mëparshme;

- të adresohen Pasqyrat Vjetore Financiare; dhe
- të adresohen çështjet e menaxhimit financiar gjatë vitit aktual.

Këtë vit ne kemi raportuar konkluzionet dhe rekomandimet tona nga auditimet e parakohshme në Memorandumet e Auditimit, në Janar të vitit 2010.

Me qëllim të përmbushjes së përgjegjësiave tona për auditimin e Kuvendit, ne kemi ndërmarrë aktivitetet si në vijim:

1. Kemi rishikuar pasqyrat financiare të Kuvendit në raport me buxhetin e miratuar për vitin 2009;
2. Kemi përcaktuar nëse pasqyrat financiare të Kuvendit janë përgatitur në pajtim me SNKSP “Raportimi Financiar në bazë të Kontabilitetit të Parasë së Gatshme”;
3. Kemi përcaktuar nivelet e materialitetit të Kuvendit, si prag për lehtësimin e përcaktimit të llojit të opinionit që duhet dhënë mbi pasqyrat financiare;
4. Kemi zbatuar një kombinim të mostrimit sipas gjykimit dhe sipas rastit, në përzgjedhjen e transaksioneve për testim;
5. Kemi kryer teste substanciale gjithëpërfshirëse mbi transaksionet financiare;
6. Jemi mbështetur në një lloj kombinimi të intervistave, rishikimeve analitike, rishikimin e dokumenteve dhe verifikimin fizik për të vlerësuar vlefshmërinë dhe rregullsinë e transaksioneve financiare;
7. Kemi vlerësuar cilësinë e punës së Njësisë së Auditimit të Brendshëm të Kuvendit;

Në këtë raport ne përmbledhim auditimin e këtij viti dhe japim një opinion formal mbi Pasqyrat Vjetore Financiare 2009.

Lidhur me opinionin tonë të auditimit për pasqyrat financiare të Kuvendit, standardet ndërkombëtare përcaktojnë kriteret specifike të cilat rregullojnë llojin e opinionit që mund të jepet. Këto janë të përcaktuara më gjerësisht në Shtojcën 1.

## **V. Opinioni i auditimit**

Për mendimin tonë pasqyrat financiare *paraqesin një pamje të drejtë dhe të vërtetë* në të gjitha aspektet materiale, pozitën financiare për vitin që përfundon më 31 Dhjetor 2009, në pajtim me standardet ndërkombëtare të kontabilitetit për sektorin publik (SNKSP) “raportimi financiar, në bazë të kontabilitetit të parasë së gatshme”. (SNISA 400 *Opinion i Pakualifikuar*)

## **VI. Gjendja e rekomandimeve të viteve të kaluara**

Raporti ynë i auditimit të Pasqyrave Financiare të vitit 2008 kishte dhënë tetë rekomandime, lidhur me përmirësimin e menaxhimit financiar të Kuvendit. Ne kemi vërejtur se:

- pesë rekomandime janë adresuar plotësisht;
- dy rekomandime janë adresuar pjesërisht;
- një rekomandim nuk është adresuar fare.

Rekomandimi që nuk është adresuar ende:

- Për çdo planifikim buxhetor duhet të bëhen analiza detale sipas linjave buxhetore dhe vlerave konkrete në mënyrë që shpenzimet buxhetore të jenë në pajtim me planifikimin real buxhetor. Planifikimi për nevojat buxhetore duhet përmirësohet, gjithashtu edhe monitorimi.

## VII. Të gjeturat dhe rekomandimet kryesore të auditimit

### VII.1. Rezultati Financiar në krahasim me Buxhetin e Aprovuar

Analiza e Rezultatit në Pasqyrat Financiare kundrejt Buxhetit të Aprovuar tregon:

*Tabela 1. Përshkrimi i buxhetit dhe shpenzimeve*

	2009 Buxheti fillestar	2009 Buxheti i rishikuar	2009 Buxheti final	2009 Aktual	2008 Aktual	2007 Aktual
Fondi i Përgjithshëm	9,244,727	9,622,421	9,622,421	8,225,942	8,836,532	7,035,313
Të hyrat vetanake	-	-	-	-	-	-
<b>Totali:</b>	<b>9,244,727</b>	<b>9,622,421</b>	<b>9,622,421</b>	<b>8,225,942</b>	<b>8,836,532</b>	<b>7,035,313</b>
Pagat dhe mëditjet	4,253,585	4,300,279	4,299,379	3,854,652	4,063,062	2,826,351
Mallrat dhe shërbimet	1,230,359	1,287,859	1,281,559	1,130,254	1,134,360	908,624
Komunalitë	161,000	164,500	221,200	220,100	150,091	173,546
Subvencionet dhe transferet	1,901,783	1,911,783	1,911,783	1,896,448	1,903,577	1,910,486
Shpenzimet kapitale	1,698,000	1,958,500	1,908,500	1,124,488	420,027	206,727
<b>Gjithsej shpenzimet</b>	<b>9,244,727</b>	<b>9,622,421</b>	<b>9,622,421</b>	<b>8,225,942</b>	<b>7,671,117</b>	<b>6,025,734</b>

Kolonat për Buxhetin fillestar, buxhetin e rishikuar dhe atë final nënkuptojnë ndarjet buxhetore për vitin fiskal 2009 nga Fondi i Buxhetit të Kosovës.



Pas rishikimit të BKK-së buxheti për Kuvendin ishte ngritur në një shumë prej 377,695 €. Kjo rritje ndodhi për shkak se në kuadër të Kuvendit është themeluar Këshilli i Kosovës për trashëgimi Kulturore me një buxhet prej 181,000 €, si dhe ka pasur rritje të buxhetit edhe në programet tjera.

Sipas kategorive ekonomike me rishikim ishte rritur buxheti për shpenzime kapitale në një vlerë prej 260,000 €, për subvencione dhe transfere 10,000 €, shpenzime komunale 3,500 €, mallrat dhe shërbimet për 57,500 € dhe pagat e mëditjet janë shtuar për 46,695 €.

Shpenzimet e realizuara për vitin 2009 ishin 8,225,942 € apo rreth 85% të buxhetit final. Mos implementimi i plotë i buxhetit kishte ndodhur për shkak të buxhetimit joadekuat, si dhe për shkak të mos realizimit me kohë të projekteve kapitale.

Shpenzimet për paga dhe mëditje janë realizuar rreth 90% e buxhetit final. Këtu përfshihen pagat shtesë për tërë stafin e Kuvendit në fund të vitit në vlerë prej 260,000 €.

Shpenzimet për mallra dhe shërbime janë realizuar rreth 88% e buxhetit final, pastaj shpenzimet për subvencione dhe transfere janë realizuar rreth 99% e buxhetit final.

Deri sa shpenzimet kapitale janë realizuar rreth 59% e buxhetit e ku shihet se ka përmirësim nga viti 2008 ku realizimi ishte 28%. Prej tyre 87% ishin realizuar në tremujorin e fundit të vitit.

Buxheti për shpenzime kapitale ka pësuar ndryshime dhe ridestininim të mjeteve nga një projekt në projekte tjera për shkak të dështimit në realizimin e projektit Villa Gërmija.

## **Konkluzioni**

Kuvendi nuk ka arritur të realizoj buxhetin e planifikuar, në veçanti projektet kapitale, këtë e tregon ridestininimi i shpeshtë i mjeteve në të gjitha kategoritë ekonomike, si dhe ndryshimi i projekteve të planifikuara.

## **VII.2. Pasqyrat Financiare**

### **VII.2.1. Cilësia e informatave**

Pasqyrat financiare të sektorit publik duhet të japin informata për të ndihmuar vendim marrjen dhe të japë dëshmi për përgjegjësitë e organizatës, për burimet e saja dhe transparencën gjatë shpenzimit të parasë publike ( SNKSP 1).

### **Të gjeturat**

Ne kemi analizuar nëse rritja e pasurive jo financiare nga 2008 në 2009 përputhet me vlerën e blerjeve të pasurive që kanë ndodhur gjatë vitit 2009.

Ne kemi gjetur se rritja e prezantuar në PF nuk është në harmoni me vlerën e pasurive të blera në vitin 2009. Sipas PF rritja e Pasurive jo financiare nga 2008 në 2009 është 2,249,455 € kurse pasuri të blera me vlerë mbi 1,000 € në këtë vit janë 1,065,647 €.

Arsyeja e kësaj difference është se pasuria nga vitet e mëparshme është regjistruar për herë të parë në regjistrat kontabël në vitin 2009.

### **Konkluzioni**

Kuvendi vetëm në vitin 2009 ka arritur që pasurinë e blerë viteve të mëhershme ta evidentoj në regjistrin kontabël. Ky zhvillim është inkurajues mirëpo mos shpalosja e kësaj difference mund të shkaktoj konfuzion dhe paqartësi të lexuesi i PF sa i përket ndryshimit të vlerës së pasurive.

Me përjashtim të mos shpalosjes së kësaj difference në vlerësojmë se informatat e paraqitura në pasqyrat financiare janë të kompletuara sipas kontabilitetit të parasë së gatshme.

#### **Rekomandimi 1**

Rekomandojmë Sekretarin Permanent që:

- Të vazhdoj regjistrimin e duhur dhe me kohë të të gjitha pasurive jofinanciare në regjistrin kontabël si dhe paraqitjen e tyre të plotë në PF; dhe
- Të siguroj konsistencë në raportim në mes të PF të vitit aktual me ato të viteve paraprake duke shpalosur ndryshimet e rëndësishme në mes të viteve.

## **VII.2.2 Pajtueshmëria në lidhje me raportimin e jashtëm**

Kuvendi i Kosovës ka përgatitur Pasqyrat Financiare në pajtueshmëri me UA 20/2009 mbi raportimin vjetor të Organizatave Buxhetore. Pasqyrat financiare janë të nënshkruara nga personat përgjegjës (të autorizuar) si dhe janë dorëzuar MEF-it / Thesar në periudhën e caktuar kohore.

## **VII.3 Realizimi i Buxhetit**

### **VII.3.1 Menaxhimi i Shpenzimeve**

#### **VII.3.1.1 Pagat dhe Mëditjet**

Buxheti i Kuvendit për paga dhe mëditje për vitin 2009 ishte 4,299,380 €. Shpenzimet e realizuara për këtë kategori janë 3,854,652 € ose 89,66% e buxhetit. Shuma prej 220,000 € nga kategoria paga dhe mëditje ishte transferuar në projekte kapitale.

### **Të Gjeturat :**

Ne kemi rishikuar nëse pagat dhe shtesat që marrin stafi politik dhe ai administrativ i Kuvendit paguhen përmes listës së pagave siç kërkohet me “Rregullat Financiare dhe Udhëzimet e Thesarit 02- Shpenzimi i parave publike”.

Ne kemi hulumtuar nëse ndarja e mjeteve për punë në lartësinë e një pagese mujore për të gjithë personelin e Kuvendit në emër të ngarkesës shtesë kishte ndonjë mbështetje tjetër ligjore përveç vendimit të Kryesisë së Kuvendit të datës 11 dhjetor 2009.

- Ne kemi gjetur se gjatë vitit 2009 shtesat (për komisionet e grupeve parlamentare, seanca parlamentare, staf civil, kompensime ditore) nuk janë paguar përmes listës së pagave por direkt me UOP nga sistemi i Free-Balancit;
- Ne nuk kemi gjetur ndonjë mbështetje tjetër ligjore për këtë pagesë përveç këtij vendimi të Kryesisë dhe arsyeshmëria e dhënë për ngarkesë shtesë nuk mbështetet me dëshmi për punë shtesë të kryera; dhe
- Mjetet për pagën shtesë ishin zotuar me datë 18 dhjetor 2009 pas skadimit të afatit për zotimin e mjeteve sipas UA.nr.15/2009, afati i fundit për zotimet për paga dhe mëditje ishte 9 dhjetori 2009.

### **Konkluzioni:**

Që nga fillimi i vitit 2010 Kuvendi ka arritur që çështjen e shtesave ta adresoj si duhet dhe tash çdo e ardhur kalon përmes Listës së Pagave dhe sistemit të Payrollit.

Procesimi i pagës shtesë në fund të vitit për tërë stafin duke anashkaluar procedurat formale të vendosura mund të kuptohet si tejkalim i kornizës së aplikueshme rregullative nga vet ligjvënësi. Kjo mund të shërbej si model i gabuar i menaxhimit duke inkurajuar akterët tjerë të sektorit publik për veprime të ngjashme.

### **Rekomandimi 2**

Rekomandojmë Sekretarin Permanent që:

- Të siguroj praktika të mira në menaxhimin e pagave brenda kornizës ekzistuese duke udhëhequr me shembuj të mirë që do të duhej të ndjekin të gjitha organizatat tjera të sektorit publik.

### **VII.3.1.2 Mallrat dhe shërbimet**

Shpenzimet për mallra dhe shërbime për vitin 2009 ishin 1,130,254 €. Nga kjo ne kemi testuar shpenzimet të cilat kapin vlerën 194,244 € ose 17 % e vlerës totale.

#### **Shpenzimet për Mirëmbajtjen e automjeteve**

Kuvendi i Kosovës kishte shpenzuar 28,526 € për mirëmbajtjen e automjeteve. Nga kjo vlerë Administrata e Kuvendit kishte shpenzuar 17,275 €, kurse Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës 11,250 €.

Testimi ynë është fokusuar nëse faturat për mirëmbajtjen e automjeteve kishin çmimet, përshkrimin e njëjtë dhe nëse të gjithë artikujt e faturuar ekzistojnë në specifikacionin teknik (Kontratë).

Janë evidentuar raste kur përshkrimi i pjesëve të automjeteve në faturë nuk përputhet me përshkrimin në specifikacionin teknik, kemi hasur në raste kur çmimet në faturë nuk janë përputhur me specifikacionin.

#### **Shpenzimet e telefonisë fikse**

Shpenzimet e telefonisë fikse për vitin 2009 ishin 52,390 €.

Ne kemi testuar nëse vendimi për shpenzime të telefonisë fikse respektohet dhe aplikohen ndalesat në rast se ka tejkalim.

Testet tona kanë përfshirë 2 muaj dhe kemi gjetur raste të tejkalimit të shpenzimeve të telefonit mirëpo ky tejkalim ju kishte ndalë nga paga çdo të punësuar.

#### **Konkluzioni:**

Dallimet në përshkrim (emërtim) të pjesëve në mes faturës dhe specifikacionit shkaktojnë paqartësi dhe pamundësojnë që kontrollet e brendshme të mund të identifikojnë dhe parandalojnë nëse çmimet dhe artikujt e faturuar janë të njëjta me specifikacionin teknik.

#### **Rekomandimi 3**

Rekomandojmë Sekretarin Permanent që:

- Të forcoj kontrollin i brendshëm para ekzekutimit të pagesave në mënyrë që kontrolli të verifikoj dhe parandaloj të gjitha faturat që kanë mospërputhje me specifikacionin teknik të kontratës.

### **VII.3.1.3 Investimet kapitale**

Shpenzimet e Kuvendit për investime kapitale ishin në vlerë prej 1,124,488 € ose 58% e vlerës së planifikuar.

#### **Të gjeturat**

##### **Kryerja e Pagesave jo sipas kushteve të parapara me kontratë**

Ne kemi testuar nëse pagesat janë kryer në përputhje me kushtet e parapara me kontratë.

Ne kemi gjetur se edhe pse kontrata ishte për punë "Renovimi i nyjeve sanitare", 1 javë pas nënshkrimit të saj OE ishte paguar rreth 70% nga vlera e kontratës, derisa puna nuk është kryer në atë përqindje por është pranuar vetëm materiali.

Gjatë testimit të fletëdërgesës sasia e materialit të kërkuar dhe atij të sjellur nuk përputhet plotësisht me specifikacionin teknik. Vlera e materialit të pranuar nuk e ka mbuluar vlerën e pagesës.

Njësoj ka ndodhur te Pagesa e parë për kontratën "Ndërrimi i dyerve dhe dritareve" në vlerë prej 326,054 €. Edhe te ky rast vlera e pagesës nuk përputhet me vlerën e punëve të kryera. OE i kishte kryer punimet për pjesën e dritareve deri në kohën e pagesës kur vlera e punës së kryer ka qenë në shumën 164,388 €, kurse dyert ishin pranuar në Kuvend por nuk ishin montuar.

Arsyeja e dhënë për këto pagesa ka qenë që buxheti të mos mbetet suficit dhe si version kanë pranuar materialin në vend të punës.

##### **Mbikëqyrje jo e duhur e projekteve kapitale**

Organi mbikëqyrës për projekte kapitale është kontraktuar me vonesë pasi që pagesat me vlerën më të madhe veç ishin realizuar.

Pa raport të organit mbikëqyrës janë ekzekutuar pagesat në vlerën më të madhe te projektet kapitale.

##### **Vonesa në përmbushjen e kontratave sipas planit dinamik**

Ne kemi testuar nëse punët janë kryer sipas afateve të parapara me planin dinamik.

Te Projektet kapitale për punë janë gjetur vonesa në përmbushjen e kontratës krahasuar me planin dinamik që sillet nga 4 deri në 5 muaj.

Vonesa të tilla kishte edhe në rastet kur Plani dinamik ka qenë nënkriter me 20 % të pikëve me përmbushjen e të cilit nënkriter OE edhe e ka fituar kontratën.

Me përjashtim të Kontrata për "Ndërrimin e dyerve dhe dritareve" ku me komente na janë sjellur dëshmi se janë aplikuar penalet si ndëshkim për vonesat e punëve, në dy rastet tjera Kuvendi nuk ka aplikuar penalet e kontraktuara.

Justifikimi i koordinatorit të projektit për vonesat e ndodhura ishte se OE ishte dashur të punoj vikendeve dhe natën por që ky arsyetim ishte bërë pas pranimit përfundimtar të punimeve e jo në kohën kur ka skaduar afati për përfundimin e punëve.

Shembujt vijues janë kontratat e dhëna të cilat nuk janë përmbushur sipas planit dinamik:

- Kontrata për Renovimin e Nyjeve Sanitare, dhe
- Kontrata për Instalimin e Ashensorit.

#### **Konkluzioni:**

Menaxhimi i shpenzimeve për projekte kapitale kishte të meta serioze prej fazës fillestare e deri te ekzekutimi i pagesave për këto kontrata.

Rezultat i kësaj kanë ndodhur pagesat para kryerjes së punës, vonesat në kryerjen e punëve për një kohë mjaft të gjatë dhe mundësia që në mungesë të një mbikëqyrje adekuate të punës edhe kualiteti i punëve të mos jetë në nivelin për çka kanë paguar.

#### **Rekomandimi 4**

Rekomandojmë Sekretarin Permanent që:

- Pagesat për projekte kapitale të bëhen në përputhje me kushtet e kontratës, për punët e kryera e jo për materialin e pranuar.
- Projektet kapitale të planifikohen, monitorohen dhe të realizohen në periudhë të përshtatshme të vitit që mjetet mos të rrezikojnë të mbeten suficit.
- Të vazhdohet praktika e filluar në aplikimin e penaleve të kontraktuara për vonesat në kryerjen e punëve.


## **VII.4 Menaxhimi i Prokurimit**

Procesi i prokurimit zhvillohet me qëllim të efikasitetit dhe ekonomizimit të shpenzimeve publike, për të ngritur kualitetin e shërbimeve publike, për të ndihmuar në zvogëlimin e kostos, në rritje të zhvillimit ekonomik dhe në zgjerim të konkurrencës.

Kuvendi ka përgatitur Planin e Prokurimit për vitin 2009 ku janë paraparë projektet që do të zhvillohen gjatë këtij viti, mirëpo ky plan ka pësuar mjaft shumë ndryshime nga ai fillestar.

Nga shpenzimet që janë bërë me procedura të prokurimit pagesat më të mëdha janë bërë në muajin dhjetor 2009 rreth 58 % e të gjitha shpenzimeve .

Nga diagrami më poshtë shihet qartë se si ka shkuar procesi i pagesave për shpenzimet që kanë pasë prokurim, ku në muajin dhjetor janë bërë pagesat më të mëdha.



*Grafiku 1. Tregon pagesat e bëra për shpenzimet që janë zhvilluar me procedura të prokurimit gjatë vitit 2009*

Ne kemi gjetur parregullsitë që janë shpalosur në shembujt në vijim:

### **Nënkriteret e vendosura**

Kemi rishikuar nëse gjatë përdorimit të kriterit ekonomikisht më i favorshëm nën kriteret e përdorura nga AK janë bërë në përputhje me LPP-në dhe nevojave reale për secilën kontratë veç e veç.

Janë aplikuar si nënkriter numri i referencave (10%) edhe pse referencat janë kërkesë për përshtatshmëri.

Te furnizimi me kompjuterë afati i liferimit ishte trajtuar si një nënkriter i mbipeshuar (me 20 % të poenëve) për vlerësimin e ofertave.

Ne nuk kemi gjetur asnjë rrethanë që tregon se kishte pasur nevojë emergjente për pranimin e tyre. Si rezultat i nënkriterit (afati i liferimit) fitues ka dalë OE i cili ishte për 2,763 € më i shtrenjtë se garuesi tjetër me çmim më të ulët.

### **Dobësitë e identifikuar në zhvillimin e procesit të prokurimit**

- Shumë projekte nuk kanë qenë të planifikuara ose ka pasë ndryshime nga projekti i planifikuar.
- AK ka pranuar sigurimin e ekzekutimit gjithmonë pas nënshkrimit të kontratës deri në 3 muaj e në disa raste edhe pas përfundimit të kontratës (pranimit të mallrave).
- Nuk janë njoftuar gjithmonë operatorët ekonomik që janë eliminuar.

### **Konkluzioni**

Prokurimi në Kuvend nuk është zhvilluar plotësisht brenda kornizës juridike të prokurimit.

Kuvendi nuk ka kontrolle të përshtatshme të cilat në mënyrë të arsyeshme sigurojnë se buxhetet e parashikuara po shpenzohen në pajtim me ligjin. Devijimet nga zbatimi i rregullave të prokurimit, si në rastet e mësipërme drejtpërdrejtë apo indirekt rrisin rrezikun e humbjes dhe keqpërdorimit të mjeteve buxhetore.

#### **Rekomandimi 5**

Rekomandojmë menaxhmentin të siguroj që:

- Të ndërmerren veprime për të forcuar procedurat e prokurimit në fushat ku janë identifikuar dobësitë e lartë përmendura.
- Nënkriteret të vlerësohen dhe peshohen drejtë sipas nevojës së AK për të rezultuar me përmbushje efektive të synimeve të organizatës.

## **VII.5 Avanset për udhëtime jashtë vendit**

Ne kemi rishikuar nëse avanset për mëditje gjatë udhëtimeve jashtë vendit janë në përputhje me UA të MAP-it.

Vendimi i kryesisë për rritje të mëditjeve nga 20 % në 30 % e kundërshton UA nr. 2004/07.

### **Konkluzioni**

Mos aplikimi i udhëzimeve në fuqi mund të ketë për pasoj menaxhimin joadekuat të parasë publike.



## **Rekomandimi 6**

Rekomandojmë Sekretarin Permanent që:

- Vendimet e brendshme të jenë në harmoni me udhëzimet e jashtme që tanimë ekzistojnë dhe i rregullojnë këto çështje për të gjitha institucionet publike.

## **VII.6 Menaxhimi i pasurive**

### **Regjistri kontabël i pasurive jo financiare është ende i pa kompletuar**

Ne kemi testuar nëse të gjitha pasuritë jo financiare të Kuvendit, me vlerë mbi 1,000 € janë regjistruar në regjistrin kontabël.

Është inkurajuese që gati e gjithë pasuria jo financiare e viteve të mëparshme ishte regjistruar gjatë vitit 2009 në regjistrin kontabël. Megjithatë kemi gjetur se në PF (Regjistrin kontabël) të vitit 2009 nuk figuronte i regjistruar rezervari i ujit me vlerë prej 4,000 €, si dhe shtëpiza për sigurim me vlerë prej 3,900 € edhe pse sipas zyrtarëve të Kuvendit dhe dokumentacionit kjo ka ndodhur mirëpo ka ndonjë gabim teknik në sistem.

Ne po ashtu kemi gjetur se në PF (Regjistrin kontabël) të 2009 nuk ishin regjistruar pasuritë që janë pronë e KPM-së e që kanë vlerë mbi 1,000€ siç janë vetura me vlerë prej 14,800 € dhe fotokopja me vlerë prej 1,497 €.

Në komentet që ka dhënë Entiteti ndaj draft raportit tonë na janë ofruar dëshmi të mjaftueshme që sigurojnë se të gjitha pasuritë e lartpërmendura janë evidentuar në regjistrin kontabël të vitit 2010.

### **Inventarizimi i Pasurisë**

Udhëzimi Administrativ nr. 21/2009 për Menaxhimin e Pasurisë Qeveritare kërkon që çdo Organizatë Buxhetore është e obliguar një herë në vit para përfundimit të çdo viti fiskal të bëjë inventarizimin e të gjitha pasurive që janë në posedimin e saj.

Inventarizimi i pasurive është bërë mirëpo gjatë analizimit të tij ne kemi vërejtur se në raportin e paraqitur nga komisioni për inventarizim i Kuvendit, nuk është regjistruar asnjë kompjuter, fotokopje dhe pajisje tjetër e cila gjendet dhe kontrollohet nga kjo organizatë buxhetore.

Regjistri i Pasurive të OB ka qenë e pamundur të krahasohet me Inventarizim në fund të vitit në mungesë të evidentimit të plotë të pasurisë, dhe ne nuk kemi qenë në gjendje të konstatojmë nëse gjithë pasuria është evidentuar në këtë regjistër.

## **Konkluzioni:**

Mangësitë e vërejtura lidhur me pasuritë themelore tregojnë që Kuvendi ende nuk ka një menaxhim të duhur të pasurive themelore.

Organizata buxhetore përmes inventarizimit të pasurive për vitin 2009 nuk ka prezantuar në mënyrë të saktë të gjitha pasuritë që i posedon, duke mos ofruar kështu siguri të të dhënave mbi pasuritë e organizatës.

### **Rekomandim 7**

Rekomandojmë Sekretarin Permanent që:

- Komisionet e formuara duhet të kryejnë një inventarizim të plotë dhe të pavarur nga çdo regjistër tjetër .

## **VII.7 Sistemi i kontrollit të brendshëm**

Bazuar në të gjeturat dhe konkluzionet tona kemi ardhur në përfundim se kontrollet e brendshme të Kuvendit janë të dizajnuara në disa fusha, por në disa tjera ka nevojë akoma për përmirësimin e tyre.

Ne kemi identifikuar dhe raportuar disa mangësi në funksionimin e sistemit të kontrolleve të brendshme në fushat në vijim:

- Kontrolle të pamjaftueshme gjatë realizimit të pagesave posaçërisht në fund të muajit dhjetor;
- Mbikëqyrje jo e duhur e projekteve kapitale gjatë realizimit të tyre;
- Dobësi në zbatimin e procedurave të parapara të Prokurimit; dhe
- Dobësi në menaxhimin e pasurive.

## **Konkluzioni**

Kuvendi ka arritur të vendos një sistem të kontrolleve të brendshme por që ende ka mundësi që në disa fusha të përmirësohen dhe të evitohen parregullsitë e evidentuara.

Në përgjithësi, ne konsiderojmë se niveli i kontrollit të brendshëm ka hapësirë të përmirësohet sipas standardeve dhe praktikave më të mira në mënyrë që të ofrojnë një siguri më të lartë në fushat e caktuara, duke i adresuar rekomandimet tona të nxjerra në këtë raport.

### **Rekomandimi 8**

Rekomandojmë Sekretarin Permanent që të siguroj:

- Kontrolle më të mira në menaxhimin e shpenzimeve dhe pagesave posaçërisht në fund të vitit.
- Vendosijen e një sistemi funksional të kontrollit të brendshëm, duke kërkuar përgjegjësi dhe raportime në të gjitha nivelet e lartëpërmendura.

## **VII.8 Auditimi i Brendshëm**

Auditimi i brendshëm është segment i rëndësishëm për të siguruar menaxhmentin e lartë se mekanizmat e kontrollit të brendshëm janë dizajnuar dhe zbatohen në mënyrën e duhur. Aty ku vërehet se kontrollet e brendshme nuk funksionojnë si duhet, auditimi i brendshëm ofron këshilla dhe rekomandime se si ato të përmirësohen.

Gjatë periudhës 2009 auditori i brendshëm bazuar në vlerësimin e rrezikut dhe prioriteteve ka kryer gjashtë auditime në fusha të ndryshme. Fushat e Audituarat kanë qenë: Prokurimi i vitit 2008, Shpenzimet e telefonit, Shpenzimet e Patty Cashit dhe Avanseve, Menaxhimi i Depos, Menaxhimi i Personelit dhe Auditimi për mallra -shërbime dhe komunal.

Ne kemi vërejtur se auditimi i brendshëm në planin vjetor nuk e kishte paraparë të kryej ndonjë auditim të fushave siç janë Prokurimi dhe Menaxhimi i Pasurive dhe nuk e kishte bërë për periudhën e vitit 2009 si fusha me rrezik të lartë .

### **Konkluzioni**

Bazuar në kapacitetet ekzistuese është bërë një punë e mirë dhe janë prekur disa nga fushat me rrezik. Auditimi i këtyre dy fushave do ta përmirësonte edhe më tepër sistemin e kontrollës së brendshme në lidhje me shpenzimin e parave publike.

### **Rekomandimi 9**

Rekomandojmë Sekretarin Permanent që:

- Auditori i brendshëm planin vjetor dhe aktivitetet e auditimit duhet ti fokusoj më tepër në drejtim të fushës së Prokurimit dhe Menaxhimit të Pasurive si fusha me rrezik të lartë dhe të kryej auditimin e tyre gjatë vitit aktual .

## **VII.9 Një konkluzion i përgjithshëm**

Kuvendi nuk ka arritur ende plotësisht të vendos një sistem funksional të kontroleve të brendshme për parandalimin e gabimeve gjegjësisht parregullsive të mundshme.

Në përgjithësi, ne konsiderojmë se kontrolli i brendshëm përkundër progresit ende ka nevojë të përmirësohet.

Në planifikimin e Buxhetit ende ka dobësi e të cilat kanë pasur për pasojë direkt edhe në implementimin e projekteve tjera dhe vonesat në realizimin e tyre.

Në menaxhimin e procesit të prokurimit janë vërejtur dobësi të shpenzimet për investime kapitale. Kjo dhe dobësitë e tjera të identifikuar në këtë raport na kanë shtyrë deri te një konkluzion i përgjithshëm se nevojitet angazhim nga menaxhmenti për të siguruar një mjedis të kontrollit i cili do të siguronte një menaxhim më të mirë të parasë publike.

Po ashtu kemi vërejtur mangësi edhe në menaxhimin e pasurive, e cila rritë rrezikun për keqpërdorimin e tyre respektivisht humbjen e tyre.

Si rezultat i gjithë kësaj ne e rekomandojmë menaxhmentin që praktikatat, sistemet dhe proceset ekzistuese të analizohen në fushat me mangësi të theksuara me qëllim të ndërmerren veprime përmirësuese që do të përkrahin arritjen e objektivave të Institucionit.

## Shtojca 1

### Llojet e ndryshme të Opinioneve të Auditimit të zbatuara nga ana e ZAP në Raportet Vjetore të Auditimit për vitin 2009

(e shkëputur nga ISSAI 400)

9. Një opinion i auditimit normalisht është në format standard, ndërlidhur me pasqyrat financiare si tërësi, duke shmangur nevojën për të caktuar gjatësinë e saj por duke bartur sipas natyrës së saj një kuptim të përgjithshëm tek lexuesit sipas kuptimit të saj. Natyra e këtyre fjalëve do të ndikohet nga korniza ligjore e auditimit, por përbërja e opinionit duhet të tregoj qartë a është i pakualifikuar apo i kualifikuar, apo nëse është i kualifikuar në disa çështje të caktuara apo është opinion i kundërt (paragrafi 14), apo është mohim i opinionit (paragrafi 15).

10. Një **opinion i pakualifikuar** jepet kur auditori është i kënaqur në të gjitha aspektet materiale që:

- (a) pasqyrat financiare janë përgatitur duke shfrytëzuar baza dhe politika të pranuar të kontabilitetit të cilat janë zbatuar në mënyrë konsistence (të qëndrueshme);
- (b) pasqyrat janë në pajtim me kërkesat statusore dhe rregulloret relevante;
- (c) pamja e paraqitur në pasqyrat financiare janë përputhje me njohuritë e auditorit në lidhje me entitetin e audituar;
- (d) është një shpalosje adekuate e të gjitha çështjeve materiale relevante për pasqyrat financiare.

11. **Theksim i çështjes.** Në disa rrethana auditori mundet të konsideroj se lexuesi nuk do të kuptoj në mënyrë të duhur pasqyrat financiare nëse vëmendja është përqendruar në çështje të pazakonshme apo të rëndësishme. Si një rregull e përgjithshme, auditori kur jep një opinion të pakualifikuar kjo nuk i referohet ndonjë aspekti specifik të pasqyrave financiare në opinionin e tij në rast se kjo mund të interpretohet gabimisht si opinion i kualifikuar. Me qëllim të shmangies së kësaj përshtypjeje, referencat që janë menduar si ;nënvizim i çështjes; gjinden në paragrafët e ndara nga opinionit. Sidoqoftë, auditori nuk duhet të përdor nënvizimin e çështjes për të përmirësuar mungesën e shpalosjeve të duhura në pasqyrat financiare apo si alternativ, zëvendësim për kualifikim të opinionit.

12. Auditori mund të **mos jetë në gjendje të shpreh një opinion jo të kualifikuar** kur ekziston një nga ato rrethana dhe në gjykimin e auditorëve, afektin e tyre është ose mund të jetë materiale për pasqyrat financiare:

- (a) ka patur limitime në fushëveprimin e auditimit;
- (b) Auditori konsideron që pasqyrat janë jo komplete apo çorientues apo ekziston një ndarje e pajustificuar nga standardet e pranueshme të kontabilitetit; apo
- (c) Ekzistojnë paqartësi që ndikojnë në pasqyrat financiare.

13. **Opinionit i Kualifikuar.** Aty ku auditori nuk pajtohet ap nuk është i sigurt në lidhje me një ose me tepër artikuj të veçantë në pasqyrat financiare e që janë materiale por jo edhe fundamentale në kuptimin e pasqyrave, duhet të jepet një opinion i kualifikuar. Formulimi i opinionit normalisht tregon një rezultat të kënaqshëm ndaj subjektit të audituar, sa i përket një pasqyre të qartë dhe koncize, të çështjeve të mospajtimit apo edhe të paqartësive që ngrisin opinion të kualifikuar. I ndihmon përdoruesit e pasqyrave nëse efekti financiar i paqartësisë apo edhe i mosmarrëveshjeve është përcaktuar nga ana e Auditorit edhe pse kjo nuk është gjithmonë praktike apo relevante.

14. **Opinion i Kundërt.** Aty ku Auditori nuk ka mundësi të jap një opinion mbi pasqyrat financiare në tërësi, për shkak të mosmarrëveshjeve që është aq thelbësore ngase e minon pozitën e prezantuar në vazhdim që opinionin që kualifikohet në aspekte të caktuara nuk do të jetë adekuat, atëherë jepet opinion i Kundërt. Formulimi i një opinionin të tillë e bën të qartë se pasqyrat financiare nuk janë prezantuar në mënyrë të drejtë, duke specifikuar qartë dhe në mënyrë koncize të gjitha çështjet e mosmarrëveshjeve. Përsëri, është një ndihmesë që efekti financiar mbi pasqyrat financiare përcaktohet aty ku duhet dhe është praktik.
15. **Mohimi i Opinionit.** Aty ku Auditori nuk mund jep opinion në lidhje me pasqyrat financiare, të marrë si tërësi për shkak të paqartësisë apo restriksione të fushëveprimit që është thelbësor që një opinion që është i kualifikuar në aspekte të caktuara nuk do të jetë adekuat, jepet opinion i kundërt. Formulimi i një opinionin të tillë të kundërt e bën të qartë që një opinion nuk mund të jepet, duke specifikuar në mënyrë të qartë dhe koncize të gjitha çështjet e paqarta.
16. Është bërë zakon që ILA të ofrojnë një raport të detajuar për të plotësuar opinionin në rrethana në të cilat është e pamundur të jepet një opinion jo i kualifikuar.

## Shtojca 2: Komentet e Kuvendit dhe Përgjigja e ZAP-it ndaj Komenteve

Menaxhmentit të Kuvendit i është dhënë mundësia për të dhënë komente mbi draftin e këtij raporti. Menaxhmenti ka dhënë një numër komentesh të cilat i kanë qartësuar çështjet e ngritura dhe më pas janë bërë disa ndryshime. Çështjet e papërfunduara, për të cilat ne si auditorë dhe entiteti i audituar ende kemi pikëpamje të ndryshme, janë si më poshtë:

Rekomandimet	Pajtohe mi	Pjesërisht pajtohem i	Nuk Pajtohe mi	Komentet e Kuvendit	Komentet e ZAP-it
<b>Rekomandimi 1</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>Të vazhdojë regjistrimi i duhur dhe me kohë të të gjitha pasurive jofinanciare në regjistrin kontabël si dhe paraqitjen e tyre të plotë në PF.</li> </ul>		X		<ul style="list-style-type: none"> <li>E gjetura flet për dy pasuri (rezervuari i ujit 4,000 € dhe shtëpiza e sigurimit 3,900€), të cilat kanë qenë të regjistruara Në sistemin e FREE Balancit janë pasuritë në regjistrin kontabël.  <b>ANEKS. Provë 1a</b></li> </ul>	E gjetura në këtë rast ju ka referuar faktit që Pasuritë e viteve të mëparshme kanë arritur që gati plotësisht të regjistrohen vetëm në vitin 2009 dhe për këtë është inkurajuar menaxhmenti, por që një numër i vogël i pasurive të vitit 2009 nuk janë evidentuar.
<ul style="list-style-type: none"> <li>Të siguroj konsistencë në raportim në mes të PF të vitit të kaluar me ato të viteve paraprake duke shpalosur ndryshimet e rëndësishme në mes të viteve.</li> </ul>		X		<ul style="list-style-type: none"> <li>Në vitin 2009, është e regjistruar e gjithë pasuria që jep dallimin në mes të vitit 2008 - 2009  <b>ANEKS. Provë 1b (i njëjti material)</b></li> </ul>	Kjo diferencë në mes të vlerës së blerjeve gjatë vitit aktual dhe regjistrimit në të njëjtin vit nuk është shpalosur në PF për të sqaruar rritjen e pasurive jofinanciare andaj mbeten konstatimet e pandryshuara.
<b>Rekomandimi 2</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>Të siguroj praktika të mira menaxheriale në menaxhimin e financave publike brenda kornizës ekzistuese duke udhëhequr me shembuj të mirë që do të duhej të ndjekin të gjitha organizatat tjera të sektorit publik.</li> </ul>			X	<ul style="list-style-type: none"> <li>Rekomandim i adresuar jo saktë,  <b>ANEKS Provë 2. Vendimi.</b>  a)Rekomandimi i komisionit për buxhet dhe financa.  b)Vendimi i kryesisë Nr. 03-V-244 dt. 11 dhjetor 2009</li> </ul>	Mbeten konstatimet e pandryshuara Ne kemi qenë të informuar për këto vendime , por që bazë ligjore tjetër për këtë pagesë nuk kemi gjetur.

<p><b>Rekomandimi 4</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>Pagesa për projekte kapitale të bëhen në përputhje me kushtet e kontratës, pra për punët e kryera e jo për materialin e pranuar.</li> </ul>		X		<ul style="list-style-type: none"> <li>Aktivitetet e prokurimit kanë ndodhur në tremujorin e fundit dinamika e realizimit ka kërkuar kohë më të gjatë të realizimit të kontratave Andaj janë bërë pagesat në bazë të raportit të komisionit mbi sasinë e mallit të pranuar të cilat janë paguar pjesërisht për mall e pjesërisht për punët e kryera.</li> </ul> <p><b>ANEKSI Prova 4 proceset e komisionit për lëndët. 1 .2.3</b></p>	<p>Kontratat kanë qenë për punë dhe konform këtyre kushteve duhet edhe pagesat të ndodhin.</p> <p>Mbeten konstatimet e pandryshuara.</p>
<ul style="list-style-type: none"> <li>Projektet kapitale të planifikohen, monitorohen dhe të realizohen në periudhë të përshtatshme të vitit që mjetet mos të rrezikojnë të shkojnë në suficit.</li> </ul>				<ul style="list-style-type: none"> <li>Monitorimi dhe mbikëqyrja realizohet varësisht nga situacioni me zyrtar brenda autoritetit. Për projektet tjera kemi kontratë me OE.</li> </ul> <p><b>ANEKS Prova 5a) Vendimi NR-03-V-167 dt. 26 maj 2009 b)kontrata me OE</b></p>	<p>Grafiku i pagesave të realizuara dhe ndryshimet nga plani i prokurimit e mbështesin konstatimin tonë në këtë të gjetur.</p>
<ul style="list-style-type: none"> <li>Të aplikohen penalet për vonesa në realizimin e punëve sipas kontratave.</li> </ul>				<ul style="list-style-type: none"> <li>Penalet janë aplikuar gjatë vitit 2009 në këto pagesa përfundimtare :</li> </ul> <p><b>ANEKSI Prova 6: pagesa.</b></p>	<p>Menaxhmenti i Kuvendit ka filluar adresimin e penaleve te kontrata e dyerve dhe dritareve,e që është inkurajuese mirëpo ende nuk është adresuar te të gjitha kontratat, që kanë pasur vonesa.</p>
<p><b>Rekomandimi 5</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>Të ndërmerren veprime të menjëhershme për të forcuar procedurat e prokurimit në fushat ku janë identifikuar dobësitë e lartpërmendura.</li> </ul>				<ul style="list-style-type: none"> <li>Procedurat e prokurimit janë në pajtim me LPP, dhe zbatimi i këtyre procedurave është obligim permanent.</li> </ul> <p><b>ANEKSI Prova 7</b></p>	<p>Të gjeturat të cilat i kemi cekur janë pjesë e procedurave të prokurimit në pajtim me LPP-në të cilat nuk janë respektuar.</p>



<ul style="list-style-type: none"> <li>Nën kriteret të vlerësohen dhe peshohen drejtë sipas nevojës së AK për të rezultuar me përmbushje efektive të synimeve të organizatës.</li> </ul>				<ul style="list-style-type: none"> <li>Nën kriteret janë aktivitetet i cili aplikohet në bazë të nenit 50.2 të ligjit të prokurimit . <b>Shih tekstin e ligjit.</b></li> </ul>	Nuk janë ofruar dëshmi që mohojnë konstatimin tonë.
<p><b>Rekomandimi 6</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>Vendimet e brendshme të jenë në harmoni me udhëzimet e jashtme që tanimë ekzistojnë dhe i rregullojnë këto çështje për të gjitha institucionet publike.</li> </ul>				<ul style="list-style-type: none"> <li>Rekomandimi i adresuar jo saktë. <b>ANEKSI PROVA 7 Vendimi Nr.03-V-094 dt. 4 nëntor 2008</b></li> </ul>	Nuk janë ofruar dëshmi që mohojnë konstatimin tonë.
<p><b>Rekomandimi 7</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>Të verifikoj dhe shtojë kujdesin nëse të gjitha pasuritë e regjistruara ekzistojnë edhe në regjistrin kontabël.</li> <li>Komisionet e formuara duhet të sigurojnë një inventarizim të plotë dhe të pavarur nga çdo regjistër tjetër.</li> </ul>				<ul style="list-style-type: none"> <li>Kuvendi, pasurin e ka të regjistruar.</li> <li>b) KPMK- gjithashtu e ka pasur të regjistruar pasurin por ka pasur mospërputhje të kompetencave në mes të MAP-it dhe Kuvendit.</li> <li>Komisioni ka bërë inventarizimin komplet të pasurisë së Kuvendit çka është rekomandim i implementuar. Nga draft projekti. <b>ANEKSI Prova 8 Lista e regjistrimit të pasurisë</b></li> </ul>	Inkurajohet menaxhmenti për hapat e ndërmarr , dhe meqenëse regjistrimet janë kryer ne e pranojmë këtë gjendje të krijuar. Kurse edhe pse na është ofruar një listë e inventarizimit ne nuk mund ta pranojmë sepse kjo duhet të ndodhë në kohën e inventarizimit me komision në fund të vitit siç e kërkon udhëzimi për pasuritë.

<p><b>Rekomandimi 8</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Kontrolle më të mira në menaxhimin e shpenzimeve dhe pagesave posaçërisht në fund të vitit.</li> <li>• Mbikëqyrjen e projekteve kapitale, dhe</li> <li>• Menaxhimin e pasurive dhe prokurimit.</li> </ul>				<ul style="list-style-type: none"> <li>• Pagesat janë njëkohësisht të mbuluara me raportin e pranimit të komisioneve përkatëse. <b>ANEKSI Prova 9. Procesverbalet e pranimit</b></li> <li>•Për situacionet e caktuara monitorimi dhe mbikëqyrja realizohet me zyrtaret e Kuvendit</li> <li>•Për projektet e mëdha kemi kontrata me OE.</li> <li><b>ANEKS - Kontrata (prova nr 5 b).</b></li> <li>•Menaxhimi i prokurimit dhe pasurisë është aktiviteti i cili menaxhohet në periudha të caktuara raportuese.</li> </ul>	<p>Të gjeturat të cilat i kemi cekur janë pjesë e kontrolleve të brendshme e të cilat nuk janë respektuar .</p>
<p><b>Rekomandimi 9</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Planin vjetor ta fokusoj me tepër në drejtim të fushës së Prokurimit dhe Menaxhimit të Pasurive si fusha me rrezik të lartë dhe të kryej auditimin e tyre gjatë vitit fiskal.</li> </ul>				<p>Prokurimi dhe menaxhimi i pasurisë janë aktivitete permanente të auditorit të brendshëm dhe për vitin 2009 janë draft raportet si dhe për auditimet tjera janë ne dijeni ZAP-i. <b>ANEKS Prova 9 Procesverbali</b></p>	<p>Nuk janë kryer raporte që kanë mbuluar këto fusha gjatë vitit 2009 kështu që konstatimet tona mbeten të pandryshuara</p>

